



KONFERENCA KOMBËTARE E SHKENCAVE MJEKËSORE 6 / 9-11 Maj 2019

1. Udhëzues për përgatitjen e abstraktit për Prezantim Oral

Formati i Abstraktit

- **Titulli:** Titulli duhet të jetë Times New Roman, madhësia 12 pt dhe bold.
- **Emri i autorit:** Emri i plotë i autorit (autorëve), institucioni dhe adresa e e-mail-it
- **Abstrakti:** Teksti duhet të jetë Times New Roman, madhësia 10-12 pt, hapësirë midis rreshtave 1,0
- **Fjalët kyçe:** Duhet të shkruhen në Times New Roman, madhësia 10, dhe italic.
- **Formati:** Abstrakti duhet të paraqitet formati Microsoft Word Document.

Informacione mbi abstraktin

a) Titulli

Titulli, i përbërë nga 8-15 fjalë, është elementi i parë që mund të tërheqë vëmendjen e lexuesit ndaj punimit.

Për të zgjedhur një titull të mirë duhet pasur parasysh:

- Titulli duhet të tërheqë vëmendjen e lexuesit
- Duhet të jenë “formalë” – jo shumë të zgjuar ose të lezetshëm
- Ai duhet t’i referohet temës kryesore ose qëllimit kryesor të punimit dhe të mos keq-orientojë lexuesin mbi përmbajtjen e tij
- Titulli duhet të jetë sa më specifik të jetë e mundur duke marrë parasysh gjatësinë e tij
- Disa prej fjalëve kyç që do të renditen më poshtë duhet të jenë pjesë e titullit
- Një titull i mirë duhet të mundohet t’i përgjigjet pyetjeve të mëposhtme:
 1. **Çfarë** do të studiohet?
 2. **Si** do të studiohet çështja e përzgjedhur?
 3. **Me kë?** – përshkruani target-grupin dhe grupin e referencës
 4. **Ku/Në çfarë konteksti** është zhvilluar studimi?

Në mënyrë që të përfshihen të gjitha pikat e mësipërme në titull, këshillohet që titulli të ndjekë strukturën e mëposhtme:

Shembull: Tema ose çështja kryesore: lloji i studimit + popullata + zona gjeografike

Qëndrimet mbi shëndetin mendor: Një studim mbi qëndrimet e studentëve të mjekësisë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.



KONFERENCA KOMBËTARE E SHKENCAVE MJEKËSORE 6 / 9-11 Maj 2019

b) Qëllimi

Qëllimi kryesor i shkrimit të një abstrakti është të angazhojë lexuesin duke i treguar për çfarë flet punimi dhe pse duhet lexuar ai.

c) Abstrakti

Abstrakti është një përmbledhje e shkurtër e punimit. Shumica e lexuesve lexojnë fillimisht vetëm abstraktin për t'u siguruar që punimi është relevant për temën që u intereson. Për këtë arsye ai jo vetëm duhet të jetë informues por dhe 'reklamues' mbi studimin në vijim. Mungesa e qartësisë dhe informacionit janë dhe problemet kryesore me një abstrakt. Një abstrakt i mirë duhet të përmbajë 7 elementë kryesorë, të sugjeruar më poshtë:

- Abstrakti duhet të fillojë me një fjali të shkurtër që prezanton temën ose çështjen kryesore që do të trajtojë punimi, për të tërhequr vëmendjen e lexuesit
- Më pas duhet të nënvizojë qëllimin kryesor të studimit.
- Duhet të theksohet rëndësia akademike ose praktike e studimit në fjalë
- Të shpjegohet shumë shkurt metodologjia e përdorur
- Të përmbledhen gjetjet kryesore
- Një deklaratë konkluzive duhet të theksojë rëndësinë e studimit në mbushjen e boshllëqeve në informacionin ekzistues
- Në fund duhen renditur rekomandimet praktike që lindin bazuar në gjetjet e studimit.

Gjithashtu kini parasysh teksa shkruani abstraktin:

- Duke qenë se abstrakti është një përmbledhje e punimit, mos përfshini në të informacione që nuk ofrohen/përmenden në punim/prezantim
- Mos harroni se abstrakti nuk është hyrja e punimit. Për këtë arsye punimi duhet të jetë i plotë dhe pa të.
- Zakonisht abstrakti shkruhet si një paragraf i vetëm dhe duhet të jetë i mjaftueshëm për të dhënë një ide fillestare rreth artikullit dhe studimit
Është mirë që në abstrakt të mos ketë jo vetëm figura dhe tabela, por dhe as referenca në tekst. Referencat përdoren vetëm në rastet kur në abstrakt është i nevojshëm citimi i studimeve të mëparshme.

d) Abstrakti/përmbledhja e një rasti klinik

Për ata psikoterapistë që dëshirojnë të prezantojnë praktikën e tyre psikoterapeutike përmes një rasti klinik, udhëzojmë të kenë parasysh edhe këto sugjerime për përmbledhjen e punimit, po ashtu edhe për prezantimin:



KONFERENCA KOMBËTARE E SHKENCAVE MJEKËSORE 6 / 9-11 Maj 2019

- Tema që do trajtojnë përmes rastit klinik
- Teoria e praktikës terapeutike të cilës i referohen
- Prezantimi i rastit klinik
- Një histori e procesit(punës) terapeutik me këtë pacient : raporti me pacientin, teknika dhe strategji terapeutike të përdorura, hipoteza dhe dyshime.
- Konkluzione

Vëmendje!

Prezantimi i rastit klinik duhet të bëhet në respekt të anonimatit të pacientit dhe me lejen e miratuar me shkrim të këtij të fundit, e cila depozitohet pranë KSH, pas miratimit të abstraktit.

e) Fjalët kyç

Maksimumi 5 fjalë kyç duhet të përfshihen menjëherë pas abstraktit. Fjalët kyç shërbejnë për të tërhequr vëmendjen e lexuesit, si dhe për përzgjedhjen e artikujve në baza elektronike informacioni. Fjalët kyç është mirë që të përmbledhin temën, nëntemën, llojin e studimit, popullatën, vendin e zbatimit të studimit.



KONFERENCA KOMBËTARE E SHKENCAVE MJEKËSORE 6 / 9-11 Maj 2019

2. Udhëzues për përgatitjen e abstraktit për Prezantim Poster

Formati i posterit

- Përmasat e posterit duhet të jenë: **A1 (594 x 841 mm)** ose **70 x 100 cm**.
- Posteri duhet të jetë i printuar **me ngjyra**.

Përmbajtja e posterit

a) Titulli

Titulli prezanton në 1-2 rreshta shkurtimisht çështjen që mbulon punimi dhe qasjen kërkimore të përdorur; autorin/autorët; institucionin që përfaqësojnë. Shkrimi i përdorur për titullin është më i madh se shkrimi i pjesës tjetër të tekstit.

b) Qëllimi

Qëllimi i një posteri është prezantimi i një pune kërkimore / shkencore në mënyrë vizuale dhe sa më tërheqëse për të nxitur interesin dhe diskutimet e atyre që e shohin atë. Është shumë e rëndësishme që posteri të japë informacionin më të rëndësishëm dhe jo detaje të punimit, të jetë i thjeshtë dhe jo i ngarkuar si me figura dhe grafikë ashtu edhe me tekst. Posteri duhet të paraqesë një punim original. Një poster duhet të përmbajë jo më shumë se 800 fjalë. Seksionet që duhet të përfshihen në një poster janë si më poshtë:

c) Organizimi i materialit

Hyrja: Është seksioni që prezanton në linja të përgjithshme qëllimin e punimit, pikënisjen dhe mënyrën e realizimit të tij (jo më shumë se 200 fjalë).

Materialet dhe metodologjia: Në këtë seksion shikuesi njihet me metodologjinë kryesore të zgjedhur për këtë punim, mënyrën si është përdorur dhe grupet e përfshira në të (jo më shumë se 200 fjalë).

Rezultatet: Paraqiten gjetjet kryesore të punimit (jo më shumë se 200 fjalë).

Konkluzionet: bazuar në gjetjet e punimit theksohet rëndësia e informacionit që ky punim sjell dhe mund të jepen rekomandime praktike në lidhje me fushën apo çështjen e mbuluar nga punimi (jo më shumë se 200 fjalë)

Referenca: 5 -10 citime.

Falenderime: Nëse ka individë ose institucione që kanë kontribuar në realizimin e këtij punimi, kjo është një hapësirë që mund të bëhet me fjalë ose dhe shoqëruar me logot përkatëse. Gjithashtu këtu është vendi për të deklaruar ndonjë konflikt të mundshëm interesi. (Ky seksion nuk është i detyrueshëm)



KONFERENCA KOMBËTARE E SHKENCAVE MJEKËSORE 6 / 9-11 Maj 2019

Për më shumë informacion: Këtu autori i jep mundësinë të interesuarve për të mësuar më shumë në lidhje me punën e tij, nëse dëshiron, përmes një adrese institucioni, etj. (Ky seksion nuk është i detyrueshëm)

Abstrakti për poster

Posteri në vetvete është një paraqitje koncize e një punimi ose studimi të caktuar. Abstrakti i posterit në këtë rast kërkohet për t'ju dhënë mundësinë të përfaqësoheni në librin e abstrakteve që do të botohet në përfundim të aktivitetit. Për udhëzime të nevojshme për përgatitjen e një abstrakti të tillë referojuni sugjerimeve të mësipërme në këtë dokument.

Shënim: Sjellim në vëmendjen e aplikuesve se abstrakti/përmbledhja do të përdoret në Konferencë për të përshkruar punimin që do të prezantoni.

Suksese!!!